

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



Programi mësimor

GJUHA ANGLEZE

për klasën I

Shkup, 2021

TË DHËNAT THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	<i>Gjuhë angleze</i>
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	I (e parë)
Temat/Fushat programore	<ul style="list-style-type: none"> ● Unë dhe të tjerët në shtëpi ● Unë dhe të tjerët në shkollë ● Unë dhe të tjerët në mjedisin e afërt ● Unë dhe të tjerët në kohën e lirë
Numri i orëve	2 orë në javë/72 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<p>Për realizimin e suksesshëm të programit mësimor të gjuhës angleze për klasat e para do të shfrytëzohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● kompjuter, printues, projektor, tabelë ● kukulla per aktivitete lojërash, fotografi, ilustrime, lodra; ● Material për përpunimin e urimeve për ditëlindje/urim për ditëlindje, letër, gërshërë, letra me ngjyra, ngjitëse, plastelinë, ngjyra druri, stilolapsa.

Normativi për kuadrin mësimor

- Studime të përfunduara për gjuhë dhe letërsi angleze - drejtimi mësimor, VII/1 ose VIA (sipas KMK) dhe 240 EKTC;
- Studime të kryera për gjuhë dhe letërsi angleze (me profesion profesor i gjuhës dhe letërsisë angleze) VII/1 ose VI A (sipas KMK) dhe 240 EKTC;
- studime të përfunduara për gjuhë dhe letërsi angleze - drejtim tjetër me qëllim të përfitimit të njohurive pedagogjike/psikologjike e metodologjike të akredituara në institucionet e larta arsimore, VII/1 ose VI A (sipas KMK) dhe 240 EKTC;
- studime të përfunduara për mësim klasor me modul të gjuhës angleze VII/1 ose VIA (sipas KMK) dhe 240 EKTC;
- studime të përfunduara 4 vjeçare të programit studimor të gjuhës shqipe dhe angleze (me profesion profesional, profesor i gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze) VII/1 ose VI A (sipas KMK) dhe 240 EKTC;
- studime të përfunduara dylëndore për gjuhën angleze dhe një gjuhë tjetër me përgatitje adekuate pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucionet e larta arsimore të akredituara, VII/1 OSE VI A (sipas KMK) DHE 240 EKTC;
 - studime të përfunduara të gjuhës angleze (me profesion të filologut të diplomuar) me përgatitje të adekuate pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucione e larta arsimore të akredituara, VII/1 OSE VI A (sipas KMK) DHE 240 EKTC;
- studime të përfunduara për gjuhë angleze në program tjetër studimor me përgatitje adekuate pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucione e larta arsimore të akredituara, VII/1 ose VI A (sipas KMK) DHE 240 EKTC;

NDËRLIDHJA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet nga të mësuarit në programin mësimor shpjen drejt përfitimit të kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën **Shrytëzimi i gjuhëve të tjera** nga standardet kombëtare:

	Nxënësi/nxënësja di dhe mund:
II-A.1	të kuptojë fjali dhe fraza të përdorura më shpesh të cilat u referohen fushave me rëndësi personale (p.sh. informacione personale dhe familjare, nevoja dhe ineteresa);
II-A.5	të komunikojë në situata konkrete dhe të përditshme kur kërkohet këmbim i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i informatave për tema të njohura;
II-A.6	të shqiptojë qartë dhe drejt të gjitha tonet individuale dhe ato grupore duke i respektuar rregullat e akcentit dhe intonimit, gjatë së cilës parregullsitë eventuale nuk e pengojnë komunikimin;
II-A.7	të shfrytëzojë shprehje dhe fjali të përdorura më së shpeshti të cilat burojnë nga përvoja e drejtpërdrejtë dhe që kanë të bëjnë me tema dhe situata të interesit të drejtpërdrejtë;
II-A.9	t'i respektojë rregullat themelore gramatikore dhe veçoritë gjatë shprehjes me gojë dhe me shkrim.
	<i>Nxënësi/ nxënësja kupton dhe pranon se :</i>
II-B.1	nëpërmjet të mësuarit të një gjuhe tjetër e lehtëson mësimin e disa gjuhëve dhe mundësinë për komunikim me pjesëtarët e kulturave të ndryshme/grupeve gjuhësore;
II-B.3	nëpërmjet mësimit të gjuhëve të tjera zhvillohet interesi dhe kureshtja për gjuhët dhe kulturat e ndryshme;
II-B.4	nëpërmjet mësimit të gjuhëve të tjera zhvillohet respektimi i kulturave të tjera dhe përmirësohen kompetencat ndërkulturore.

Programi mësimor përfshin edhe kompetenca relevante të këtyre fushave të standardeve kombëtare: **Njohuri digjitale, zhvillim personal dhe social** dhe **kulturë shoqërore dhe demokratike**

	<i>Nxënësi /nxënësja di dhe mund:</i>
IV-A.2	të vlerësojë se kur dhe si për të zgjidhur një detyrë/problem nevojitet përdorimi efektiv dhe efikas i TIK-ut,
IV-A.5	të përcaktojë se cilat informacione janë të nevojshme për të gjetur, për të zgjedhur dhe për të marrë të dhëna digjitale, informacione

	dhe përmbajtje;
V-A.6	të parashtrijë qëllime për mësim dhe zhvillim personal dhe të punojë për tejkalimin e sfidave të cilat paraqiten gjatë rrugës drejt realizimit të tyre;
V-A.7	t'i përdorë përvojat vetanake për të lehtësuar mësimin dhe përshtatur sjelljen e tij në të ardhmen.
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në mënyrë adekuate në situatën e caktuar;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë duke shprehur empati dhe kuptim për të tjerët dhe t'i shprehë peripecitë dhe nevojat e tij në mënyrë konstruktive;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në realizimin e qëllimeve të përbashkëta duke i këmbyer pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët me ç'rast i merr parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informatë kthyesë dhe mbështetje për vetveten, por edhe të japë informacion kthyes konstruktiv dhe mbështetje në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të jep propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe ti parashohë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të sjellë vendime racionale;
VI-A.3	t'i formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe t'i trajtojë ata me respekt edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet në mes njerëzve në çfarëdo baze qofshin ato (gjinore, etnike, moshe, aftësie, statusi social etj);
VI-A.6	të identifikojë praninë e stereotipeve dhe paragjyqimeve të vetja dhe të të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit.
<i>Nxënësi/ nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është i domosdoshëm për jetën e përditshme - lehtëson mësimin, jetën dhe punën, kontribuon për përhapjen e komunikimit, për kreativitetin dhe inovacionin dhe ofron mundësi të llojllojshme për zbatimje;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/saj në masë të madhe varen nga puna që ai/ajo bën dhe nga rezultatet që ai/ajo i arrin;
V-B.4	çdo hap që ndërmerret është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/saj;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësi janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;

V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu siç ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për t'i përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve kthyesë dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.

REZULTATET E TË NXËNIT

Tema: **UNË DHE TË TJERËT NË SHTËPI**

Gjithsej: **18 orë**

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

- të përshëndesë, të prezantojë veten, të kërkojë që edhe bashkëbiseduesi të prezantohet gjatë takimit të parë dhe të përshëndesë në mënyrë joformale;
- të prezantojë familjen e tij të ngushtë para bashkëbiseduesve;
- të kuptojë domethënien e një grupi fjalësh dhe ato t'i përdorë në kontekstin e duhur (anëtarët e familjes së ngushtë dhe lojërat e fëmijëve)
- t'i përdorë përemrat vetorë I dhe YOU, përemrin dëftor THIS dhe përemrin pronor MY gjatë formulimit të fjalisë së thjeshtë në Present Simple Tense (I am, You are, I have, You have) në kontekstin e të prezantuarit dhe të poseduarit;

Përmbajtjet (dhe konceptet):

a) Funkcionet gjuhësore:

- Tungjatjeta/mirupafshim (joformale) *Hi, Hello, Bye bye*
- Prezantim i vetes: *I'm Marija/Who is this?/This is Arben.*

Standardet për vlerësim:

- Merr pjesë në një dialog të shkurtër nëpërmjet përgjigjeve të duhura për t'u përshëndetur në mënyrë joformale (me kusht që personi tjetër të flasë ngadalë dhe qartë me shpejtësi të përshtatshme për moshën e nxënësve).
- Thotë emrin e tij dhe pyet kush është personi tjetër.

<p>b) Njësitë leksikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● anëtarët e ngushtë të familjes: <i>mum, dad, brother, sister, baby</i> ● lojërat e fëmijëve: <i>a doll, a teddy bear, a car, a ball, a kite, a rope</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ● Tregon emrat e anëtarëve të familjes. ● Merr pjesë në një dialog të shkurtër nëpërmjet prezantimit të duhur të anëtarëve të familjes së ngushtë (me kusht që personi tjetër të flasë ngadalë dhe qartë me shpejtësi të përshtatshme për moshën e nxënësve). ● Riprodhon dhe në mënyrë të pavarur prodhon njësi leksikore të përvetësuara me tema lidhur me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me lodrat për fëmijë. ● Numëron lojëra të fëmijëve me njësite leksikore të përvetësuara. ●
<p>c) Strukturat gramatikore</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Përemrat vetorë: <i>I, you;</i> ● Përemrat dëftorë: <i>This is...;</i> ● Përemrat pronorë: <i>My brother / sister;</i> ● Present Simple tense of TO BE: <i>I am / You are;</i> ● Present Simple tense of TO HAVE: <i>I have / You have.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ● Përgjigjet në pyetje të thjeshta lidhur me prezantimin e vetes. ● I përdor përemrat vetorë I dhe YOU kur prezanton veten dhe kur prezanton anëtarët e familjes. ● Përdor përemrat dëftorë dhe mbiemrat pronorë në fjali të thjeshta për të shprehur përvetësimin.
<p>ç) Përmbajtje ndërkulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Halloween: <i>ëitch, pumpkin, party, candy, zombie</i> ● Happy Halloween! ● Happy Birthday! 	<ul style="list-style-type: none"> ● Identifikon dhe dallon festat nga një incizim i dëgjuar. ● Riprodhon dhe prodhon në mënyrë të pavarur njësitë leksikore të përvetësuara lidhur me temat e festave dhe ditëlindjeve. ● Uron ditëlindjen
<p>Shembuj të aktiviteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Arsimitari përshendet dhe prezanton veten. ● Nxënësit reagojnë në mënyrë të përshtatshme dhe përshendesin në mënyrë joformale. ● Arsimitari me intonacion të duhur shqipton njësitë leksikore lidhur me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me lodrat e fëmijëve. ● Nxënësit dëgjojnë dhe përsërisin njësitë leksikore lidhur me anëtarët e familjes dhe me lodrat e fëmijëve. ● Nxënësit bëjnë një <i>Family Book</i> me vizatime të antarëve të familjes së ngushtë. ● Nxënësit vizatojnë lodrat sipas një incizimi të dëgjuar. 	

- Nxënësit tregojnë atë që zotërojnë (show and tell) *I have a doll, you have a car.*
- Nxënësit këndojnë *Nursery rhymes* dhe këngë të tjera, siç janë: *Hello, Hello; The Finger Family Song.*
- Nxënësit bëjnë kartolina për ditëlinjde dhe dekore për Halloween.
- Nxënësit e dëgjojnë dhe e këndojnë këngën *Happy Birthday.*

Tema: **UNË DHE TË TJERËT NË SHKOLLË**

Gjithsej: 18 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të përshëndesë në mënyrë formale, prezantojë veten me informata shtesë (në mënyrë formale);
2. t'i zbatojë format e shkurtëra urdhërore;
3. të përdorë një numër të caktuar fjalësh (në lidhje me shkollën dhe pajisjet shkollore) në kontekst të përshtatshëm;
4. t'i përdorë përemrat vetorë, përemrat dëftorë, përemrat pronorë dhe një numër të kufizuar të foljeve gjatë formimit të fjalive të thjeshta në *Present Simple Tense* në kontekstin e prezantimit, përfitimit dhe zotërimit.

Përmbajtjet (dhe konceptet):

a) Funkcionet gjuhësore

- pershendetje (formale)
Good morning! Good afternoon! Good evening!
Good bye!: How are you? Fine, thank you;
- prezantimi i vetes
My name is... / I come from...;
- urdhëresa
Listen and repeat / Look at this / Pick up / Sit doën / Stand up / Come in.

Standardet për vlerësim:

- Merr pjesë në një dialog të shkurtër nëpërmjet përgjigjeve të duhura për t'u përshëndetur në mënyrë formale me shprehje të sjellshme (me kusht që personi tjetër të flasë ngadalë dhe qartë me shpejtësi të përshtatshme për moshën e nxënësve).
- Thotë emrin e tij (në një mënyrë formale) dhe jep informacione të tjera për veten e tij.
- Në mënyrë joverbale përgjigjet ndaj fjalive të shkurtëra urdhërore.
- Në mënyrë joverbale paraqet fjalitë e shkurtëra urdhërore të përvetësuara me lëvizje adekuate të trupit.
- Riprodhon dhe në mënyrë të pavarur prodhon fjali të shkurtëra urdhërore të përvetësuara.

<p>b) Njësitë leksikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● njerëz dhe vende: <i>a school, a classroom, a student, a teacher, a friend;</i> ● pajisje shkollore: <i>a book, a pen, a pencil, a pencil case, a rubber, a bag.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ● Identifikon dhe dallon pajisjet shkollore dhe objektet në klasë pas një incizimi të shkurtër të dëgjuar. ● Riprodhon dhe në mënyrë të pavarur prodhon njësi leksikore të përvetësuara për tema që lidhen me shkollën. ● Numëron pajisjet shkollore dhe objektet në klasë me njësitë e përvetësuara leksikore.
<p>c) Strukturat gramatikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● përemrat vetorë: <i>I, you;</i> ● përemrat dëftorë: <i>This is...;</i> ● përemrat pronorë: <i>My teacher/pencil; Your book/pen;</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ● Përgjigjet në pyetje të thjeshta në lidhje me të dhëna personale për të shprehur përvetësimin nëpërmjet zbatimit të duhur të strukturave gramatikore dhe modeleve themelore të fjalive. ● Përdor foljet: <i>look, sing, draw</i> në kontekstin e duhur.
<ul style="list-style-type: none"> ● foljet: <i>look, sing, draë;</i> ● Present Simple Tense of TO BE: <i>I am / You are my friend;</i> ● Present Simple Tense of TO HAVE: <i>I have a friend. / You have a pencil.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ● Përdor përemrat dëftorë dhe përemrat pronorë në kontekstin e shprehjes së përvetësimit. ● Zbaton si duhet strukturat gramatikore kur paraqet dhe shpreh posedim.
<p>ç) Përmbajtje ndërkulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Christmas: <i>Christmas tree/card, decoration, Santa Claus, present</i> ● Merry Christmas! ● Happy New Year! 	<ul style="list-style-type: none"> ● Riprodhon dhe prodhon në mënyrë të pavarur njësitë leksikore të përvetësuara lidhur me temat e festave. ● Uron Krishtlindjet. ● Uron Vitin e Ri.

Shembuj të aktiviteteve:

- Nxënësit zhvillojnë dialog me njëri-tjetrin në të cilin përshtendeshin në mënyrë formale.
- Mësimdhënësi dramatizon një tregim në lidhje me njësitë leksikore në lidhje me pajisjet shkollore.
- Nxënësit shqiptojnë fjalë që tregojnë pajisje shkollore.
- Nën mentorimin e mësimdhënësit nxënësit luajnë lojëra për praktikimin e fjalorit të përvetësuar:
 - loja me të qëlluar (blindfold guessing game / tactile game): nxënësi me sy të mbyllur duhet ta qëllojë se cili është mjeti (pajisja shkollore), duke e marrë nga kutia/çanta e mbyllur;
 - lojëra me dëgjim dhe reagim joverbal (blindfold guessing game / tactile game): siç janë: *Simon says: Pick up a pencil!* ; *Simon says: Stand up!* ; *If you're happy and you know it...*
- Nxënësit punojnë kartolina dhe zbukurime për Vitin e Ri/Krishtlindje.
- Nxënësit dëgjojnë dhe këndojnë këngë: *We wish you a Merry Christmas ; Jingle Bells.*

Tema: **UNË DHE TË TJERËT NË MJEDISIN E AFËRT**

Gjithsej: 18 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. ta kuptojë domethënien e njësive të dëgjuara leksikore për temat që janë të lidhura me mjedisin e afërt (natyrën dhe kafshët) dhe ato t'i përdorë në kontekst të duhur;
2. të numrojë nga 1 deri 10 në kontekst të ndryshëm;
3. ta përshkruajë mjedisin e afërt me modelet themelore të fjalive të përvetësuar;
4. t'i përdorë përmerat vektorë, emrat, mbiemrat cilësorë, mbiemra (ngjyrat), si dhe një numër foljesh gjatë formulimit të fjalive të thjeshta në Present Simple Tense në kontekstin e përshkrimit, dallimit të njëjësit dhe shumësit, dallimit të ngjyrave dhe të shprehurit e përvetësimit në fjalitë të thjeshta dëftore.

Përmbajtjet (dhe konceptet):	Standardet për vlerësim:
<p>a) Funkcionet gjuhësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Prezantimi i kafshëve shtëpiake dhe të kafshëve të egra: This is ... / It is ...; ● Numrimi deri në 10: one, two, three.... 	<ul style="list-style-type: none"> ● Prezanton kafshët shtëpiake, kafshët e përkëdhelura dhe kafshët e egra. ● Në mënyrë joverbale i përgjigjet një detyre të dëgjuar me numra prej 1 deri 10. ● Identifikon dhe dallon numrat nga një deri 10 pas një incizimi të shkurtër të dëgjuar. ● Riprodhon dhe në mënyrë të pavarur prodhon funksione gjuhësore të përvetësuara të temave që janë të lidhura me rrethin e afërt dhe kafshët.
<p>b) Njësitë leksikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● vende: a park (roundabout, wing), a farm; ● kafshët shtëpiake: a cow, a pig, a chicken, a horse, a sheep; ● kafshët e përkëdhelura: a cat, a dog, a fish; ● kafshët egra: a rabbit, a lion, a bear. 	<ul style="list-style-type: none"> ● I thotë emrat e vendeve në mjedisin e tij të afërt të paraqitura në njësitë mësimore. ● Identifikon dhe I thotë emrat e kafshëve shtëpiake, kafshët e përkëdhelura dhe kafshët e egra. ● Merr pjesë në një dialog të shkurtër lidhur me mjedisin e tij të afërt, me kusht që personi tjetër të flas ngadalë dhe qartë, me ritëm të përshtatshëm sipas moshës së nxënësve
<p>c) Struktura gramatikore</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Përemrat vetorë: I, you, it, they; ● Njëjësi dhe shumësi i rregullt (emrat): book / books, horse / horses ● Mbiemrat cilësorë: a big elephant / a small cat / an old car / a neë school / a happy girl / a sad boy; ● Mbiemrat (ngjyrat): red, blue, green, black; ● Foljet: love, like / don't like, jump, walk, run; ● Present Simple Tense of TO BE: I am / We are; ● Present Simple Tense of TO HAVE: Ëe have a dog. / They have a fish ● Fjali të thjeshta; I have a farm 	<ul style="list-style-type: none"> ● Përdorë përmerat vetorë <i>it</i> dhe <i>they</i> gjatë prezantimit të kafshëve shtëpiake. ● Bën dallimin e emrave në njëjës dhe shumës. ● Përgjigjet në pyetje të thjeshta në lidhje me mjedisin e tij të afërt, duke zbatuar me saktësi strukturat gramatikore dhe modelet themelore të fjalive. ● I njeh dhe i përdorë mbiemrat cilësorë: <i>big, small, old, new, happy, sad</i>, në kontekst të duhur gjatë përshkrimit. ● I njeh/i thotë emrat/i dallon/i përdor ngjyrat: <i>red, blue, green, black</i>, përmes mbiemrave përkatës në kontekst të ndryshëm. ● Zbaton në mënyrë të duhur strukturat gramatikore gjatë përshkrimit. ● Dallon foljet <i>like/don't like</i> dhe i përdor në mënyrë të drejtë në kontekstin e duhur. ● Riprodhon fjali të thjeshta dëftore.

<p>ç) Përmbajtje ndërkulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Mother's Day: love, card, balloon, gift; I love you! ● Easter: eggs, Easter bunny; Happy Easter! 	<ul style="list-style-type: none"> ● Riprodhon dhe në mënyrë të pavarur prodhon njësitë e përvetësuar leksikore për tema që lidhen me festat. ● Uron Ditën e Nënës. ● Uron Pashkët.
<p>Shembuj të veprimtarive:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Arsimtari tregon emrin e një kafshë të caktuar, ndërsa nxënësit e demonstrojnë atë me anë të ilustrimit. Pastaj arsimtari demonstroi një ilustrim me një kafshë të caktuar, ndërsa nxënësit thonë emrin e kafshës së paraqitur. ● Nxënësit numërojnë prej 1 deri 10 duke i përdorur gishtat. ● Nxënësit bëjnë puppets (dog, cat, fish...) nga qese të vogla prej letre dhe më pas me ta interpretojnë një shfaqje kukullash, duke përdorur vokabularin e përvetësuar. ● Nxënësit tregojnë emrin e një kafshe të caktuar dhe më pas e imitojnë atë me zë (<i>cat - meow, dog - woof, sheep - baa, cow - moo</i>). ● Nxënësit përshkruajnë pamjen e një kafshe shtëpiake ose kafshe të egër, me ngjyrat e dhëna (brown bear, white sheep). ● Nën mbikëqyrjen e arsimtarit, nxënësit luajnë lojëra për ushtrimin e fjalorit të përfituar: <ul style="list-style-type: none"> - lojëra me asociacione (association games), si në lojën <i>What animal am I?</i> ku imitohet një kafshë e caktuar, ndërsa të tjerët ia qëllojnë. - lojëra me hamendje (guessing games), siç është përshkrimi i një kafshe dhe hamendja: <i>It is small. It swims. What is it? - A fish</i>; pantomimë. ● Nxënësit ndëgjojnë dhe këndojnë Nursery rhymes (<i>Baa baa black sheep; I have a pet; Ten little Indians; Five little monkeys; One, Two, Three, Four, Five; Old MacDonald Had a Farm</i>),- këngë me fjalë të përsëritura (chants) dhe këngë, të tilla si: <i>My dear, dear, Mummy, I love you very much....</i> (March 8, Mother's Day in Europe). ● Nxënësit bëjnë kartolina për <i>Mother's Day (Dita e Nënës)</i>. ● Nxënësit bëjnë kartolina për Festën e Pashkëve. 	

Tema: **UNË DHE TË TJERËT NË KOHËN E LIRË**

Gjithsej: 18 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të kuptojë domethënien e njësive leksikore të dëgjuar për tema që lidhen me kohën e lirë (pushimin)/kushtet e motit/automjetet dhe t'i përdorë ato në një kontekst të përshtatshëm;
2. të kërkojë falje, të lutet, të falemenderojë dhe pranojë/refuzojë diçka në mënyra të thjeshta dhe me mirësjellje.
3. të përshkruajë pushimin e vet (kohën e lirë) me folje të thjeshta.
4. t'i përdorë përemrat vetorë, emrat, mbiemrat (ngjyrat) si dhe një numër ta caktuar foljesh, gjatë formulimit të fjalive të thjeshta në Present Simple Tense në kontekstin e përshkrimit të stinëve të vitit dhe t'i shprehë veprimtaritë në fjali të thjeshta dëftore.

Përmbajtjet (dhe konceptet):	Standardet për vlerësim:
<p>a) Funkcionet gjuhësore:</p> <ul style="list-style-type: none">● Mirësjellja (kërkimfalja, lutja, falenderimi, pranimi/refuzimi: <i>Please. I'm sorry. Thank you. Yes/No.</i>	<ul style="list-style-type: none">● Identifikon dhe bën dallimin e formave gjuhësore të mirësjelljes nëpërmjet një konteksti të dëgjuar.● Riprodhon forma gjuhësore të mirësjelljes kur kërkon falje, kur lutet, kur falënderon dhe kur pranon/refuzon me shprehje të thjeshta.● Merr pjesë në dialog të shkurtër duke përdorur format gjuhësore për mirësjellje.
<p>b) Njësitë leksikore:</p> <ul style="list-style-type: none">● stinët e vitit dhe pushimet: spring, summer, autumn, winter, holiday;● kushtet e motit (emra): sun, rain, snow, clouds;● mjetet transportuese: car, bus, train, boat, scooter, bike.	<ul style="list-style-type: none">● Thotë emrat e katër stinëve të vitit.● Përdor fjalën <i>holiday</i> për të treguar se është në pushim.● Përdor emra (<i>sun, rain, snow, clouds</i>) për t'i përshkruar kushtet e motit.● Identifikon njësitë e parapara mësimore të cilat paraqesin mjete transportuese

<p>c) Strukturat gramatikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● përemrat vetorë: I, you, it, they; ● mbiemrat (ngjyrat) white, yellow, pink; ● foljet (aktivitetet): swim, run, ski, walk, ride, fly, jump; ● Present Simple Tense of TO BE: It is spring; ● fjalitë e thjeshta dëftore: In summer, we swim. / I ride my blue scooter in spring. / In autumn, it rains. 	<ul style="list-style-type: none"> ● Zbaton përemrat vetorë për vetën e parë, të dytë dhe të tretë njëjës dhe vetën e tretë shumës. ● I njuh dhe i përdor ngjyrat: white, yellow, pink, nëpërmjet përemrave të përshtatshëm. ● I njuh dhe i përdor foljet e parapara të cilat shprehin aktivitete: swim, run, ski, walk, ride, fly and jump. ● Tregon stinët e vitit me formën e foljes <i>TO BE</i> në Present Simple Tense ● Riprodhon fjali të thjeshta dëftore të lidhura me aktivitete në kohë të caktuar të vitit dhe me mjete të caktuara transporti.
<p>ç) Përmbajtje ndërkulturore</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Have a nice summer! ● Have a good trip! ● Have a safe trip! ● Father's Day: love, card, balloon, gift. 	<ul style="list-style-type: none"> ● Uron verë të këndëshme. ● Uron rrugë të mbarë. ● Uron udhëtim të sigurt. ● Uron Ditën e Babait.
<p>Shembuj të aktiviteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Nxënësit ushtrojnë intonacion për njësitë leksikore që lidhen me stinët e vitit, kushtet e motit dhe mjetet transportuese. ● Nxënësit nëpërmjet lojës me role, i zbatojnë format për mirësjellje, për kërkimfalje, lutje, falënderime dhe pranim/refuzim të diçkaje. ● Nxënësit bëjnë një kalendar me ndryshimet të cilat ndodhin në natyrë gjatë stinëve të vitit. ● Nxënësit plotësojnë gojarisht shprehje me konceptet e përvetësuara të tipit: <i>The sun is.....yellow. The sky is....blue.</i> ● Nxënësit tregojnë emrat dhe ngjyrosin materiale të bëra më parë në formë të vizatimeve lidhur me mjetet transportuese. ● Nxënësit e dëgjojnë dhe këndojnë këngën <i>The wheels on the Bus.</i> ● Nxënësit luajnë lojën se kush do ta qëllojë stinën e vitit (snow-winter; swim-summer) ● Nxënësit bëjnë kartolina për <i>Father's Day</i> (Ditën e babait) 	

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZI/NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen nëpërmjet përfshirjes së të gjithë nxënësve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipe gjinore. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë ndërkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlihdin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi i ndjek vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënësi. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione prapavepruese të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësimi formativ). Meqenëse në klasën e parë në lëndën e gjuhës angleze nxënësit zotërojnë aftësitë e të dëgjuarit me kuptim dhe të folurit, mësimdhënësi përcjell dhe vlerëson:

- përgjigje me gojë për pyetjet e bëra nga arsimtari ose shokët e klasës;
- reagimet dhe shfaqjet joverbale;
- reagimin ndaj instruksioneve (“Sit down”, “Come here”);
- krijimet (ilustrime, vizatime, modele, etj.)
- aktivitetet e performuara (në lojën Simon says)

Pas përfundimit të mësimit të secilës teme, nxënësit marrin shënim përmbljedhës në formën e një përshkrimi të standardeve të arritura për vlerësim. Vlerësimi përmbljedhës përdoret në periudha të caktuara të vitit shkollor dhe që lidhet me periudha të caktuara - fundi i një teme të veçantë, tremujori, gjysëmvetori ose fundi i vitit shkollor.

Fillimi i zbatimit të programit mësimit	Viti shkollor 2021/22
Institucioni/bartës i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Në pajtim me nenin 30, paragrafi 3, të Ligjit të Arsimit Fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut’ nr. 161/19 dhe 229/20), ministrja e Arsimit dhe e Shkencës miratoi programin mësimit të lëndës <i>Gjuhë angleze</i> për klasën e parë.	<p>nr. 12-6200/3 9.4.2021</p> <p style="text-align: right;">Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës Milla Carovska</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/>